



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 653/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” srl, në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-10028-05-02-2017 me objekt: *“Furnizimi i shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 166.666.500 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Sanitary Cleaning” sh.p.k.*

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e shoqërisë “Devis” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Sanitary Cleaning” sh.p.k.

Ankimues:

“Shpresa” sh.p.k
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla nr.2, Tiranë

“Devis” sh.p.k
Rr “Sami Frashëri”, Pall 22/1,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Rajonal Durrës.
Lagja nr.8, Rr.A.Goga, Durres

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka refuzuar ato, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 03.05.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. Ref-10028-05-02-2017 me objekt: “Furnizimi i shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 166.666.500 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

II.2. Në datën 24.07.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoni si më poshtë vijon:

1. “Shpresa” sh.p.k	121.333.212,00 lekë, skualifikuar
2. “Sanitary Cleaning” sh.p.k	142.857.000,00lekë, kualifikuar
3. “AGS” sh.p.k	154.997.800,75 lekë, skualifikuar
4. “Balkan Laundry” sh.p.k	158.333.175,00 lekë, skualifikuar
5. “Devis” shpk	166.190.310,00 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Shpresa” shpk, është perfaqesues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” srl, i cili është kualifikuar me arsyen se:

“1. Kontrata e bashkepunimit Nr.4242 rep dhe Nr. 1226 Rep e dates 16.06.2017 është lidhur ndërmjet “Shpresa shpk” 19.3% dhe “Servizi Sanitari Integrati shpk” 80.7 % .

A) Kontrata e Bashkepunimit në paragrafin e dytë të saj të emërtuar “Kushtet e Kontrates” nuk përmbush kërkesat e nenit 74 të VKM 914 datë 29.12.2014 duhet të ndajnë dhe përcaktojnë elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili referuar zërave të shërbimit që kërkon autoriteti kontraktor. Sa më sipër, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

B) Kontrata e bashkepunimit në paragrafin e fundit të saj të emërtuar “Detyrimet e paleve kontraktuese” e rrezon teresisht dypoziten e mesipërme ku thuhet se shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” do realizojë 80.7 % të shërbimit.

Një parashikim i tillë është në tejkalim të parashikimeve të Kodit Penal sipas të cilit përgjegjësia penale është individuale dhe Kodit Civil lidhur me detyrimet kontraktuale si dhe të Ligjit të Prokurimit Publik. Anëtarët e këtij bashkimi sipas legjislacionit shqiptar janë solidarisht përgjegjës për realizimin e kontrates në vlerën që deklarojnë se kanë marrë përsipër.

2. Anëtarët i BOE “Shpresa” shpk nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme jo më të vogël se 40% e FL.

Për përmbushjen e kërkesave për punë të ngjashme “Shpresa” shpk ka paraqitur si kontratë të ngjashme kontratën e realizuar me “Sptialin Rajonal Berat” me vlerë 10 665 000 leke pa tvsh të shoqëruar me vertetim realizimi. Në total realizimi faktik i kësaj kontrate është 8 917 379 leke . Nëse këto vlera janë pa TVSH shuma e realizuar është 7 431 149 leke pa tvsh.

Si kontratë tjetër të ngjashme Shpresa shpk ka paraqitur Kontratën e lidhur me Sky Hotel (subjekt privat) e cila është me objekt “Shërbim lavanterie” ku nuk ka të përcaktura as sasi as cmim për njësi por vetëm vlera totale e kontrates prej 4 000 000 leke pa tvsh. Konstatohet se fatura tatimore me Nr.559 me vlerë 20 000 060 leke pa tvsh nuk ka nënshkrimin e blerësit, sasinë e levruar dhe cmimin për njësi dhe si e tillë kjo faturë nuk mund të merret në konsideratë. Fatura tjetër 51 datë 01.02.2015 e sjellë për të provuar realizimin e kontratës së me Sky Hotel është me vlerë 1 999 940 leke pa tvsh. Në total si punë të ngjashme ky operator ka realizuar punë me vlerë 8 917 379 leke + 1 999 940 leke pa tvsh = 10 917 319 leke .

Bazuar ne dokumentacionin e sjelle anetari i BOE Shpresa shpk nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme pasi Shuma e kerkuar nga SRD 12 866 653 leke pa tvsh me dokumentacion justifikues ka provuar se ka realizuar pune te ngjashme me vlere 10 917 319 leke .

3. Ne lidhje me kapacitetet teknike 4 dhe 4.1 te DST Operatori ekonomik Shpresa shpk ka paraqitur Kont Qerase Nr.146 prot date 30.12.2016 e cila, kjo kontrate qeraje, nuk provon qe ky operator ekonomik ka ne dipozicion te tij ambiente per gjate gjithë kohes se kontrates per te cilen ka paraqitur oferte. Ky ambient i eshte vene ne dispozicion operatorit ekonomik Shpresa shpk per te kryer sherbimin lvanteri ekskuzivisht te Spitalit Berat, e shprehur kjo tek leja mjedisore tipi C (pika 2); Dokumentacioni ne lidhje me ambientet i sjelle nga anetari tjetër i BOE “Servizi Sanitari Integrati” nuk mund te merren ne konsiderate ne kushtet kur vendendodhja e tij eshte ne Itali, dhe nuk ka paraqitur asnje dok tjetër i cili provon se ka ne dispozicion ambiente per realizimin e sherbimit ne Shqiperi.

4. Ne lidhje me mjetet paisjet:

- *Servizi Sanitari Integrati ka paraqitur disa kontrata leasig te cilat nuk provojne pronesine e tij mbi keto mjete apo kontrata, pasi nisur nga afati i vlefshmerise se ketyre kontratave arrijme te kuptojme se pronesia mbi keto makineri ende nuk eshte e kesaj shoqërie dhe ne rast te mos pageses ato i kalojne entit financues, pra kjo shoq as nuk mund ti disponojë.*

- *Gjithashtu dok i sjelle per makinerite nga Servizi Sanitari Integrati dhe konkretish dok qe i korrepondon fatures Nr.698/15 date 25.11.2015 te leshuar nga Picchi eshte i paperkthyer dhe noterizuar dhe ne kete kushte KVO nuk mund te gjykoj ne lidhje me permbajtjen e tij.”*

Operatori ekonomik ankimues “Devis” shpk, është skualifikuar pasi:

“Vertetimi per numrin e Punonjesve (jo me pak se 21),

Nuk ploteson 12 muaj me 21 persona). Rezulton te kete jo me pak se 21 persona 11 muaj (Qershor 2016 - Prill 2017.

- Makineri larese profesionale 40 kg - 4 Cope

Ne faturat e zhdoganimit pershkruhen vetem “Pjese Makinerish Larese”

- Makineri larese profesionale me dy porta 40 kg - 1 Cope

Nuk ka

- Peshore elektrike me kapacitet mbi 100kg - 2 cope

Ne faturen tatimore nuk eshte e specifikuar pesha e peshores apo ndonje e dhene tjetër me ane te te ciles te vertetohet kenaqja e kerkesave te DT.

- Karroca / karrela sherbimi ne pavione per rroba - 20 cope

Ne fature pershkruhen 30 karroca dhe 20 shporta (kosha), megjithese ne foto jane nuk mund te percaktohet numeri i kerkuar ne DT.

II.3. Në datën 31.07.2017 operatori ekonomik ankimues “Shpresa” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“ [...] Përsa i përket pikës 1) A, BOE Shpresa sh.p.k dhe Servisi Sanitari Integrali i përmbushin kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Sipas preventivit ku përshkruhet shërbimi, ka vetëm një zë (proces pune) “Shërbim lvanterie dhe hotelerie” për 30 muaj ku jepet dhe sasia prej 476,190 kg si më poshtë. Rrjedhimisht

nuk mund të kërkohet që të ndahen dhe përcaktohen elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili referuar shërbimit që kërkon autoriteti kontraktor kur në preventiv ky shërbim është përcaktuar vetëm me një zë.

Nr	Pershkrimi i shërbimit	sasia kg	Afati
1	Shërbimi lavanterise dhe hotelerise per 30 muaj	476,190.0	30 muaj

Megjithatë në kushtet e kontratës së bashkëpunimit është bërë ndarja e punëve për secilën palë ku është sqaruar se shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k do të japë konsulencën teknike për zgjedhjen dhe blerjen e materialeve të lavanterisë si dhe për zgjedhjen e pajisjeve teknike për kryerjen e shërbimit sipas standarteve të BE. Ndërsa shoqëria “Shpresa” sh.p.k merr përsipër blerjen e materialeve dhe sigurimin e personelit për kryerjen e këtij shërbimi, sigurimin e ambientit. Përsa i përket pikës 1) B në Detyrimet e Palëve Kontraktuese te kontrata e bashkëpunimit thuhet:

- Shoqëria “Shpresa” sh.p.k ka detyrimin ligjor të vendosë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të kryejë të gjitha procedurat e duhura që lidhen me tenderimin, ndërsa shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k ka detyrimin ligjor të vendosë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shoqërisë “Shpresa” sh.p.k për t’i paraqitur në tender.
- Sipas prokurës midis palëve shoqëria “Shpresa” sh.p.k merr përsipër të deklarojë faturat tatimore për shërbimet e kryera në masën 100% të vlerës së këtij tenderi pranë organeve tatimore. Po ashtu përgjegjësia civile, penale, fiskale dhe cdo detyrim tjetër ndaj shtetit shqiptar do të jetë vetëm e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k.

Konstatimi i autoritetit kontraktor se “Një parashikim i tillë është në tejkalim të parashikimeve të kodit penal sipas të cilit përgjegjësia penale është individuale dhe Kodit Civil lidhur me detyrimet kontraktuale si dhe Ligjit të Prokurimit Publik, anëtarët e këtij bashkimi sipas legjislacionit shqiptar janë solidarisht përgjegjës për realizimin e kontratës në vlerën që deklarojnë se kanë marrë përsipër” bie poshtë pasi kjo pikë sipas kontratës së posacme vlen vetëm për pjesën financiare ku shoqëria “Shpresa” sh.p.k merr përsipër të deklarojë faturat për shërbimet e kryera në masën 100% dhe përgjegjësia civile, penale fiskale dhe detyrime të tjera ndaj shtetit shqiptar vlen vetëm për këtë pjesë. Nuk duhen marrë të shpëputura fjalët por në kontekstin e fjalisë paraardhëse.

Ne gjykojmë se kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e posacme janë dokumenta të plotësuar në përputhje të plotë me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, prandaj ky pretendim nuk mund të shërbejë si shkak për skualifikimin e ofertës sonë.

Në lidhje me pikën 2 ju sqarojmë si më poshtë:

Sipas nenit 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” BOE “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” ka paraqitur dokumentacionin për dëshmitë e përvojës së mëparshme në përputhje të plotë me përcaktimet e mësipërme, sepse në vërtetimin dhe faturat tatimore të paraqitura janë të evidentuara datat, shumat dhe shërbimet e lavanterisë të realizuara.

Konkretisht përse i përket kontratës me Spitalin Rajonal Berat janë paraqitur dy vërtetime, një bashkëngjitur kontratës me vlerën e plotë dhe një tjetër me realizimin faktik që i korrespondon viteve 2014, 2015, 2016 me vlerë 8.917.433 lekë pa tvsh. Në kontratën e lidhur me Sky Hotel autoriteti kontraktor ka cituar se kjo kontratë nuk ka as sasi as cmim për njësi por vetëm vlera totale, ndërkohë që edhe kontrata e lidhur me Spitalin Rajonal Berat që është quajtur e vlefshme nuk i ka të përmendura sasi, cmim për njësi por vetëm vlerë totale. Kjo nuk do të thotë që të quhen të pavlefshme. Ju sqaromë se sasia dhe cmimi për njësi janë të paraqitura në situacionet përkatëse të cilat nuk kanë qenë pjesë e kërkesave të tenderit.

Lidhur me konstatimin se fatura tatimore me nr. 559, me vlerë 2.000.060 lekë pa tvsh nuk ka nënshkrimin e blerësit, sasinë e lëvruar dhe cmimin për njësi dhe si e tillë kjo faturë nuk mund të merret në konsideratë, sipas nenit 28, në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin priavt, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Fatura e paraqitur i ka të gjitha elementët e kërkuar sipas këtij neni ku kërkohet data, shuma dhe shërbimi i realizuar. Përse i përket faturës që nuk ka nënshkrimin e blerësit ju bëjmë me dije se edhe kopjet e faturave të paraqitura pranë institucionit tuaj prej disa vitesh nuk e kanë nënshkrimin tuaj, por kjo nuk do të thotë që këto fatura të konsiderohen të pavlefshme.

Ju sqarojmë se kjo faturë është deklaruar si nga blerësi dhe nga shitësi. Bashkëngjitur po ju dërgojmë faturën (kopjen e dytë) me firmën e blerësit, librin e shitjeve të shoqërisë Shpresa sh.p.k dhe kërkesën e drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj për vërtetësinë e kësaj fature.

Është kompetencë e organeve tatimore të marrin masa për një faturë jo të saktë por jo të quhet e pavlefshme nga ana e autoritetit kontraktor. Në momentin që kjo faturë konsiderohet e pavlefshme është e barazvlefshme me një faturë fallco.

[...] Në total si punë të ngjashme "Shpresa" sh.p.k ka realizuar punë me vlerë $8.917.433 + 1.999.940 + 2.000.060$ lekë pa tvsh = 12.917.433 lekë pa tvsh. Shpresa sh.p.k e plotëson kriterin për punë të ngjashme pasi shuma e kërkuar është përmbushur sipas përqindjes së bashkëpunimit. Pavarësisht sqarimeve si më lart, në dokumentat e tenderit për kontratat e realizuara me subjektet private kërkohet që të paraqitet kontrata përkatëse dhe /ose fatura tatimore të shitjes. Ne i kemi paraqitur të dyja. Rrjedhimish nuk mund të quhet e pavlefshme në momentin që është kërkuar si alternativë.

Referuar pikës 3 shoqëria "Shpresa" sh.p.k ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj pike në DST. [...] Nga autoriteti kontraktor kërkohet që operatori ekonomik të disponojë ambiente ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanterisë. Të vërtetojë me dokumentacionin përkatës për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanterisë e cila është në pronësi apo e marrë me qira.

Nga ana juaj jemi skualifikuar se kjo kontratë qiraje nuk provon që ky operator ekonomik ka në dispozicion të tij ambient për gjatë gjithë kohës së kontratës për të cilën ka paraqitur ofertë dhe (ky) ambient i është vënë në dispozicion shoqërisë "Shpresa" sh.p.k për të kryer shërbimin e lavanterisë ekskluzivisht Spitali Berat, e shprehur kjo te leja mjedisore tipi C (Pika 2).

Në kërkesë nuk specifikohet që kontrata të ketë afat gjatë gjithë kohës së realizimit të kontratës. Ju bëjmë me dije se kontrata me Spitalin Berat është lidhur gjithmonë me afat një vjeçar dhe rinovohet cdo vit. Është e vërtetë që kjo kontratë është vënë në dispozicion shoqërisë “Shpresa” sh.p.k për të kryer shërbimin e lavanterisë ekskluzivisht Spitali Berat, e shprehur kjo te leja mjedisore tipi C (pika 2). Nuk është kërkuar që ambienti të mos jetë në funksion të ndonjë kontrate publike apo private ose afërsia e tij me qytetin e Durrësit.

Përsa i përket dokumentacionit për ambientin e paraqitur nga SSI, vlen e njëjta gjë, ku në DST nuk është kërkuar të jetë brenda territorit të Shqipërisë. Paraqitja e ambientit nga ana e SSI tregon që ka kapacitetet teknike të mjaftueshme për këtë shërbim [...].

Referuar pikës 4 për kontratën leasing (qira financiare) në kodin civil të Republikës së Shqipërisë përfshihet në Kreun VI-Qiraja Dispozita të Përgjithshme, neni 849

“Me kontratën e qirasë financiare, njëra palë detyrohet të vërë në dispozicion të palës tjetër, për një kohë të caktuar, një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, kundrejt një pagese me afate periodike, të përcaktuar në lidhje me vlefën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe, eventualisht me elementë të tjera sipas marrëvesjes së palëve. Sendi duhet të jetë fituar ose të jetë ndërtuar nga qiradhënësi sipas dëshirës dhe përshkrimit të qiramarrësit, dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë në mbarim të afatit të kontratës, kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar. Qiradhënësi përgjigjet ndaj qiramarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e sendit si dhe për të metat e sendit. Me marrëveshje mund të parashikohet që qiramarrësi, para se të kërkojë nga qiradhënësi të drejtat e tij, duhet t’i drejtohet atij që i dha sendin (furnizuesit) për të drejtat e tij ose që i janë kaluar atij.”

Shoqëria SSI është një shoqëri që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e lavanterisë që prej vitit 2008, me një numër prej 77 punonjësish, xhiro mesatare për tre vitet e fundit 4.750.357 euro dhe me normë të lartë fitimi sipas bilanceve të paraqitura. Shoqëria SSI operon nëpërmjet kontratave leasing jo se nuk ka kapacitete financiare por me qëllimin e vetëm rinovimin e mjeteve të tij në mënyrë të vazhdueshme.

Përsa i përket dokumentacionit të paraqitur nga SSI, është i rregullt dhe me vulë apostile, pavarësisht se nuk kërkohej në dokumentat e tenderit. Fatura nr. 698/15 lëshaur nga Picchi është e papërkthyer pasi është lënë nga ana jonë me qëllimin e vetëm të lidhjes së vulës apostile.

Kjo faturë përmban karroca dhe karrela të cilat i ka paraqitur shoqëria “Shpresa” sh.p.k, konkretisht në faturën nr. 961, datë 15.07.2014 dhe nuk ishte e nevojshme të përkthehej si dokument. Autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë një operator për një dokument të paraqitur tepër [...].

Përsa i përket kualifikimit të operatorit ekonomik “Sanitary Cleaning” sipas të dhënave të marra nga faqja e QKB, kjo kompani e ka datën e regjistrimit në 29.12.2014. Rrjedhimisht për vitin 2014 kjo shoqëri rezulton me të ardhura zero. [...] Duke qenë se kjo shoqëri është regjistruar në 29.12.2014, bilanci i kërkuar nuk ka xhiro vjetore për vitin 2014. Gjithashtu në dijeninë tonë edhe pse me bashkim operatorësh kjo shoqëri ka mjaft mangësi në tërësi dhe në mënyrë të vecantë përsa i përket pikës 3.3 të kapacitetit teknik.”

II.3.1. Në datën 02.08.2017 nëpërmjet shkresës nr. 1585/4 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.3.2. Në datën 11.08.2017 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.3.3. Në datën 14.08.2017 ankimuesi ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik informacion shtesë në lidhje me ankesën nr.327 prot, datë 11.08.2017 për operatorin ekonomik “Sanitary Cleaning”.

II.3.4. Në datën 23.08.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1374/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1644/2 prot., datë 21.08.2017 me objekt: “Dërgim infomacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.4. Operatori ekonomik ankimues “Devis” shpk, pretendon se në datën 31.07.2017 ka nisur me postë ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“[...] Kompania Devis është skualifikuar për këto arsye:

1. Vërtetim për numrin e punonjësve jo më pak se 21 nuk plotëson 12 muaj me 21 persona, rezulton të ketë jo më pak se 21 persona për 11 muaj (qershor 2016-prill 2017).

Lidhur me këtë pikë ku ju keni skualifikuar kompaninë tonë, ju bëjmë me dije se bashkëlidhur gjeni vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të cilat janë të ngarkuara në dosjen e tenderit ku nr i punonjësve e kalon 21.

2. Makineri larëse profesionale 4 copë, në faturën e zhdoganimit shkruhet pjesë e një makinerie larëse profesionale, makineri larëse profesionale me dy porta nuk ka.

- Përsa i përket kësaj pike në sistem keni të ngarkuar më shumë se 10 makineri larëse profesionale me kapacitet mbi 40 kg. Nëse ju nuk e kuptoni që në njërin nga faturat e zhdoganimit shkruhej pjesë e një makinerie larëse profesionale e cila është fjala e fundit e shkencës një supër makineri profesionale me kapacitet larjeje 500 kg në orë prodhuar enkas për lavanterinë tonë në vitin 2016 dhe që ka kushtuar mbi 560 mijë euro, mund të kishit pyetur kompaninë tonë ose në një pikë doganore që tua shpjegonte se si lexohet një faturë zhdoganimi ose në një pikë doganore.

- Përvec faturave të zhdoganimit keni një faturë DEF Center Al sh.p.k datë 10.01.2011 ku përpara emërimit të makinerive keni nga një kod që për secilin, po ta fusni në faqen e internetit, do t'ju dalë që Uhm067 është barrierë profesionale me dy porta, 65 kg dhe për makineritë e tjera të cilat janë me kapacitet 65 kg secila, gjithashtu keni fatura zhdoganimi nga Renzzaci srl të makinerive larëse copë 3 kg me kapacitet 55 kg dhe makineri tharëse copë 3 e kapacitet 55 kg. Ju bëjmë me dije se kompania jonë është e vetmja në Shqipëri që disponon Makinerinë Barrieren Larëse Profesionale.

3. Peshore elektronike me kapacitet mbi 100 kg, në faturën tatimore nuk është përcaktuar pesha e peshores si dhe karroca karrela shërbimi nëpër pavijone 20 copë.

Lidhur me këtë pikë ju bëjmë me dije se peshoret elektrike janë të gjitha mbi 100 kg dhe n.q.s ato janë peshore për matjen e peshës së njerëzve, ndërsa përta i përket karrocave apo karrelave, bashkëngjitur gjeni faturat të cilat janë të ngarkuara në sistem ku numri i tyre e kalon 70 copë.

4. Mungon deklarata mbi gjendjen gjyqësore.

Edhe përta i përket kësaj pike e cila nuk qëndron, bashkëlidhur gjeni shtojcën nr.8, deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të cilën e keni të ngarkuar në sistem.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave [...] ka kualifikuar ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sanitary Cleaning”, shoqërisë “A.G.L Landry” srl si dhe subjektit fizik Mimoza Deliu.

Më poshtë po ju paraqesim disa fakte të pakontestueshme që faktojnë kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë Sanitary Cleaning”, shoqërisë “A.G.L Landry” srl si dhe subjektit fizik Mimoza Deliu si dhe shkeljet ligjore.

Pasi u njohëm me renditjen kualifikuese, shoqëria Devis sh.p.k së bashku me konsulentët e saj ligjorë, ka bërë verifikimet e saj në shtetin Shqiptar dhe atë Italian ku ushtrojnë aktivitete bashkimi i operatorëve ekonomikë Sanitary Cleaning, shoqërisë “A.G.L Landry” srl si dhe subjektit fizik Mimoza Deliu. Duke iu referuar të dhënave të mbledhura rezulton se;

AGL srl rezulton se nuk plotëson asnjë nga kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit pasi dhe ato dokumenta që ai ka paraqitur nuk kanë vullë apostile; bazuar në konventën e Hagës të 5 tetorit 1961, të gjitha dokumentat më parë duhet të jenë të legalizuara në vendin e origjinës pastaj të përkthehen dhe noterizohen në shtetin shqiptar (d.m.th në secilin nga dokumentat që të huajt paraqesin duhet të kenë nga një vullë apostile nga vendi i cili vjen, në këtë rast nga Italia).

Përta i përket shoqërisë Sanitary Cleaning rezulton se kjo kompani ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2015 vetëm me shërbime pastrimi godinash apo ambientesh që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit në fjalë. Dhe nëse kjo kompani në vitin 2017 ka filluar të kryejë edhe këtë lloj shërbimi ajo nuk i kap kurrësi asnjëherë 10% të kontratës së bashkëpunimit që kanë krijuar. Kjo shoqëri nuk disponon asnjë nga makineritë që ju keni kërkuar. Kjo shoqëri nuk disponon kontratë qiraje për ambient lavanterie dhe nëse ka sjellë ndonjë të tillë te ju, ajo duhet të jetë e noterizuar ose e skanuar ku të dallohen qartë të gjitha vullat.

Shoqëria Sanitary Cleaning nuk disponon Akt Teknik kundra zjarrit.

Personi fizik Mimoza Deliu në kontratën e bashkëpunimit merr përsipër 30% të punës. Përta i përket këtij personi fizik, nga të dhënat që disponojmë, ky operator kap vetëm 12% të kontratës. Po ju bëjmë vetëm një llogaritje të vogël, nëse personi fizik Mimoza Deliu ka masën 30% të kontratës, ajo normalisht duhet të ketë 30% të xhiros vjetore që ju po ta mblidhni do ta shihni që nuk e plotëson këtë kriter. Ky operator nuk ka vërtetim të shlyerjes së energjisë elektrike, nuk disponon asnjë lloj certifikate ISO, nuk ka akt teknik kundra zjarrit, nuk ka numrin e punonjësve, nuk ka QKB etj.”

II.4.1. Në datën 10.08.2017 operatori ekonomik ankimes ka protokolluar dorazi me nr. 1625 prot, ankesën e tij në autoritetin kontraktor me të njëjtën përmbajtje si edhe ajo e pretenduar si në pikën “II.4”.

II.4.2. Në datën 14.08.2017 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje me email ankimuesit, për ankesën e protokolluar dorazi në datën 10.08.2017, e cila,(sipas ankimuesit) nuk është as e firmosur dhe as e protokolluar. Kjo ankesë nuk është marrë në shqyrtim nga autoriteti kontraktor pasi afati i fundit i dorëzimit të ankesës në AK ka qënë data 01.08.2017.

II.4.3. Në datën 17.08.2017 në adresën e postës elektronike të ankimuesit ka mbërritur edhe përgjigja e autoritetit kontraktor për ankesën e parë në AK, të datës 10.08.2017 (të nisur me postë në datën 31.07.2017) me përmbajtjen si më poshtë:

“Ju bëj me dije se shqyrtimi i ankesës tuaj është bërë edhe me paraqitjen e saj në sekretarinë e Spitalit Rajonal Durrës me shkresën e datës 10.08.2017 me nr. prot. 1625.

Megjithatë ne e kemi disponibilitetin të kthejmë edhe njëherë të fundit përgjigjen ndaj ankesës tuaj në lidhje me ankesën e depozituar me nr. prot. 1625/2, datë 14.08.2017 e paraqitur nga ju në Spitalin Rajonal Durrës si Autoritet Kontraktor, për procedurën e hapur që po zhvillohet me mjete elektronike me objekt: “Furnizimi i shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 166.666.500 lekë pa tvsh. Spitali Rajonal Durrës si autoritet kontraktor mori në shqyrtim pretendimet tuaja dhe ju bën me dije sa më poshtë:

Vlerësimi për këtë procedurë ka përfunduar me datë 24.07.2017, nëpërmjet sistemit e-procurement në www.app.gov.al. Në zbatim të VKM nr. 914 , datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: “Gjatë procedurës së prokurimit ankesat kundër vendimeve të autoritetit kontraktor duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nësërme e punës nga data kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkellje të ligjit.” Afati i fundit për dorëzimin e formularit të ankesës ka qënë data 01.08.2017.”

II.4. 4. Në datën 22.08.2017 operatori ekonomik “Devis” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu pretendohet si vijon:

“Shoqëria Devis sh.p.k ka dorëzuar në Postën Shqiptare në Tiranë në datën 31.07.2017 ankesën e drejtuar Spitalit Rajonal Durrës. Pasi kemi pritur një përgjigje në lidhje me skualifikimin e padrejtë të shoqërisë tonë për të gjitha ato pretendime të padrejta që kishte ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për mungesë dokumentacionesh të kompanisë tonë, të cilat në të vërtetë ishin të ngarkuara në sistemin elektronik të APP-së, i jemi drejtuar sërish me një ankesë po këtë herë e kemi depozituar vetë në sekretari me nr. 1625 prot., datë 10.08.2017. Për këtë ankesë të dytë autoriteti kontraktor na kthen një përgjigje me email me datë 14.08.2017 e cila nuk është as e firmosur dhe as e protokolluar ku nuk e merr në shqyrtim ankesën tonë (bashkëngjitur këtij dokumenti).

Me datë 17.08.2017 në adresën e postës elektronike vjen dhe përgjigja për ankesën tonë të parë të cilën e kishim dërguar me postë me datë 31.07.2017 ku AK shkruan që nuk e marrim parasysh ankesën e dorëzuar prej nesh. Po nëpërmjet emailit kompania Devis i kërkon që pse e kanë cituar në shkresë që ankesa ishte dorëzuar nga ne në protokoll dhe jo nga posta të cilën ne e kishim protokolluar me postë me datë 31.07.2017, që bazuar në kodin e procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë, duhet ka kishin marrë në shqyrtim ankesën tonë.”

II.4.5. Në datën 30.08.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1406/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1691/2 prot., datë 28.08.2017 me objekt: “Dërgim infomacioni i kërkuar sipas shkresës nr. 1406 prot., dt.23.08.2017 protokolluar pranë SRD nr. 1691, dt 25.08.2017”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor sipas të cilës, oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” srl ka mangësi pasi:

“A) Kontrata e Bashkepunimit ne paragrafin e dyte te saj te emertuar “Kushtet e Kontrates” nuk permbush kerkesat e nenit 74 te VKM 914 date 29.12.2014 duhet të ndajnë dhe përcaktojnë elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili referuar zërave të shërbimit që kërkon autoriteti kontraktor. Sa më sipër, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

B) Kontrata e bashkepunimit ne paragrafin e fundit te saj te emertuar “Detyrimet e paleve kontraktuese” e rrezon teresisht dipoziten e mesiperme ku thuhet se shoqeria “Servizi Sanitari Integrati” do realizoj 80.7 % te sherbimit. Nje parashikim i tille eshte ne tejkalim te parashikimeve te Kodit Penal sipas te cilit pergjegjesia penale eshte individuale dhe Kodit Civil lidhur me detyrimet kontraktuale si dhe te Ligjit te Prokurimit Publik. Anëtarët e ketij bashkimi sipas legjislacionit shqiptar jane solidarisht pergjegjes per realizimin e kontrates ne vleren qe deklarojne se kane marre persiper”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nga verifikimet e kryera në në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë bashkëpunimi nr. 4242 Rep dhe nr.1226 Kol datë 16.06.2017 lidhur mes shoqërisë “Shpresa” shpk dhe shoqërisë “Servizi Sanitari Integrati” shpk.

Referuar seksionit “Kushtet e kontratës” të kontratës së rezulton se shtë parashikuar:

“[...] Shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k, si një shoqëri me përvojë shumë vjecare në këtë aktivitet do të bëjë organizimin dhe kryerjen e këtij shërbimi në masën 80,7% ndërsa shoqëria “Shpresa” sh.p.k do të kryejë 19,3% të këtij shërbimi. Gjithashtu shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k do të japë konsulencën teknike për zgjedhjen dhe blerjen e materialeve të lavanterisë si edhe zgjedhjen e pajisjeve teknike për kryerjen e këtij shërbimi sipas standarteve të BE. Ndërsa shoqëria “Shpresa” sh.p.k merr përsipër blerjen e

materialeve dhe sigurimin e personelit për kryerjen e këtij shërbimi, sigurimin e ambientit deri në volumn që mbulojnë kapacitetet e saj financiare.”

Ndërsa në seksionin “Detyrimet e palëve kontraktuese” është përcaktuar si vijon:

“Shoqëria “Shpresa” sh.p.k ka detyrimin ligjor të vendosë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të kryejë të gjitha procedurat e duhura që lidhen me tenderimin, ndërsa shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k ka detyrimin ligjor të vendosë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shoqërisë “Shpresa” sh.p.k për t’i paraqitur në tender.

Sipas prokurës midis palëve shoqëria “Shpresa” sh.p.k merr përsipër të deklarojë faturat tatimore për shërbimet e kryera në masën 100% të vlerës së këtij tenderi pranë organeve tatimore. Po ashtu përgjegjësia civile, penale, fiskale dhe cdo detyrim tjetër ndaj shtetit shqiptar do të jetë vetëm e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k.”

2. Prokurë e posacme nr. 4136 Rep, nr. 1193 Kol e datës 09.06.2017 sipas të cilës shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k [...] emëron si përfaqësues ligjor shoqërinë “Shpresa” sh.p.k si vijon:

“Përfaqësuesi i ngarkuar me këtë prokurë në emër dhe për llogari të këtij bashkëpunimi të shoqërive, ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, të kërkojë dhe të paraqesë të gjithë dokumentacionin e duhur, të përfaqësojë këtë bashkëpunim të shoqërive në tender me objekt: “Furnizim i shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 166.666.500 lekë pa tvsh.”

III.1.2. Në nenin 44, pika 2, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit”.

III.1.3. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.”3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të

parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Në shtojcën 12 “Termat e referencës” të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit është parashikuar:

“Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Spitali Rajonal Durres po reformon shërbimin e lavanderise duke bere kalimin e tij ne nje sipermarrje private duke perfshire ne te dhe sigurimin nga operatori ekonomik te inventarit te bute te nevojshem per plotesimin e nevojave spitalore sipas normativave qe ka Spitali Rajonal Durres deri ne shtrimin e shtratit te pacienti.

Detyrat:

- Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga procesi i lavanderisë deri tek kompletimi me inventarin e materialit të butë të shtratit të pacientit.
- Sipërmarrësi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse dhe dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuese. Përveç kësaj, sipërmarrësi duhet të sigurojë për zëvendësimin e materialit të butë, nëse është i dëmtuar apo i amortizuar (sipas kohës së tyre të amortizimit dhe sipas nevojës).
- Sipërmarrësi siguron inventarin e materialit të butë të nevojshëm, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka Spitali Rajonal Durres, me emërtimin/sigllën përkatëse të institucionit kontraktues, datën e futjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Inventari i materialit të butë, në kuptimin e kësaj kontrate, emërtimi, përmasat, dimensionet, cilësia dhe normat e përdorimit në kohë, do të përfshihen në specifikimet përkatëse.
- Sipërmarrësi do të lajë, dezinfektojë, thajë, paketojë, të transportojë dhe shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë, si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrati i pacientit.
- Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen, sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjienës me njoftimin e hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/inferm e shërbimit, si dhe sa herë të nevojitet nga shërbimi.
- Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollet e higjienës, nga marrja në dorëzim e

materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të paketuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermiore. Pjesë e këtij procesi është edhe sigurimi i pastrimit të plotë kimik – mekanik, në temperaturat e duhura, dhe i procesit të hekurosjes.

- Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në pavijone, do të bëhet me grafik të hartuar nga Sektori i Shërbimeve të Hotelerisë së Spitalit të Durrës. Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palët, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të bëhet me nënshkrim po nga të dyja palët.*
- Përdorimi i inventarit të materialit të butë brënda pavionit, bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas procedurave të mëposhtme:*

Etapat e këtij procesi çdo ditë:[...]

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” shpk dhe shoqërisë “Servizi Sanitari Integrati” shpk ka paraqitur kontratë për bashkimin e përkohshëm të tyre nr. 4242 Rep dhe nr.1226 Kol datë 16.06.2017. Në seksionin “Kushtet e kontratës” është parashikuar shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k, do të bëjë organizimin dhe kryerjen e këtij shërbimi në masën 80,7% ndërsa shoqëria “Shpresa” sh.p.k do të kryejë 19,3% të këtij shërbimi. Më tej është përcaktuar se shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k do të japë konsulencën teknike për zgjedhjen dhe blerjen e materialeve të lavanterisë si edhe zgjedhjen e pajisjeve teknike për kryerjen e këtij shërbimi sipas standarteve të BE. Ndërsa shoqëria “Shpresa” sh.p.k merr përsipër blerjen e materialeve dhe sigurimin e personelit për kryerjen e këtij shërbimi, sigurimin e ambientit deri në volumin që mbulojnë kapacitetet e saj financiare.”

Referuar kontratës së sipërcituar anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë kanë deklaruar përqindjen e bashkëpunimit mes tyre dhe më pas kanë deklaruar elementët konkretë të bashkëpunimit ku konstatohet se shoqëria «Servizi Sanitari Integrati» sh.p.k do të japë konsulencën teknike për zgjedhjen dhe blerjen e materialeve të lavanterisë si edhe zgjedhjen e pajisjeve teknike për kryerjen e këtij shërbimi sipas standarteve të BE, ndërkohë që referuar termave të referencës si më sipër cituar si dhe specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit, në asnjë rast nuk është parashikuar dhe nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktor, as në termat e referencës dhe as në specifikimet teknike shërbime që lidhen me konsulencën teknike për zgjedhjen dhe blerjen e materialeve të lavanterisë si edhe zgjedhjen e pajisjeve teknike për kryerjen e këtij shërbimi.

Gjithashtu konstatohet se në seksionin “Detyrimet e palëve kontraktuese” të kontratës së bashkëpunimit, paragrafi i dytë është përcaktuar se shoqëria “Shpresa” sh.p.k merr përsipër të deklarojë faturat tatimore për shërbimet e kryera në masën 100% të vlerës së këtij tenderi pranë organeve tatimore. Po ashtu përgjegjësia civile, penale, fiskale dhe cdo detyrim tjetër ndaj shtetit shqiptar do të jetë vetëm e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k.

Mbështetur në rregullat e prokurimit publik, në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi, kërkesë e cila ngarkon me përgjegjësi të dyja palët në këtë marrëveshje, ndërkohë që sipas kontratës së bashkëpunimit të sipërcituar përgjegjësia civile, penale, fiskale dhe cdo detyrim tjetër ndaj shtetit shqiptar do të jetë

vetëm e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k, duke e shkarkuar shoqërinë “Servizi Sanitari Integrati” sh.p.k nga cdo detyrim ndaj shtetit shqiptar, megjithëse kjo e fundit ka marrë përsipër 80,7% të shërbimit. Dipsozita mbi detyrimet e palëve kontraktuese vjen në kundërshtim me dispozitën për kushtet e kontratës pasi shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” nuk do të ketë asnjë lloj përgjegjësie civile, penale apo dhe cdo detyrim tjetër ndaj shtetit shqiptar pasi përgjegjëse do të jetë vetëm shoqëria “Shpresa” sh.p.k. Angazhimet e marra përsipër nga shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” nuk shprehin detyrimet e kësaj të fundit në raport me shoqërinë “Shpresa” sh.p.k dhe në raport me objektin e prokurimit

Pra në tërësinë e saj kjo kontratë bashkëpunimi nuk është e saktë, kushtet e përcaktuara në të kanë ngarkuar me përgjegjësi të plotë civile, penale, fiskale dhe cdo detyrim tjetër ndaj shtetit shqiptar shoqërinë “Shpresa” sh.p.k, e cila ka marrë përsipër 19.7/% (pothuajse $\frac{1}{4}$) të shërbimit, për më tepër që në këtë kontratë është parashikuar që shërbimet e kërkuara në termat e referencës do të kryhen nga kjo e fundit, pasi shoqëria e cila ka marrë përsipër $\frac{3}{4}$ e shërbimit do të ofrojë vetëm konsulencë.

Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kritereve të përcaktuara në dokumentat e tenderit si dhe kërkesave të parashikuara në ligjin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij lidhur me bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë dhe kushtet ligjore që duhet të respektojë ky grupim. Në rastin konkret, hartimi i kontratës së bashkëpunimit nuk është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi nuk janë përcaktuar në mënyrë korrekte shërbimet që do të kryejë anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë që do të realizojë 80.7% të objektit të prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit, autoriteti kontraktor nëpërmjet komisionit të vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar në një procedurë prokurimi është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit (duke përfshirë këtu edhe kriteret e veçanta të kualifikimit), dhe ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Në këtë kontekst dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim shoqërisë (kontrata e bashkëpunimit) nuk është hartuar në formën e duhur ligjore sipas parashikimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, neni 74.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të bashkimit të shoqërive “Shpresa” shpk dhe shoqërisë “Servizi Sanitari Integrati” shpk sipas të cilës: *“Ne lidhje me kapacitetet teknike 4 dhe 4.1 te DST Operatori ekonomik Shpresa shpk ka paraqitur Kont Qerase Nr.146 prot date 30.12.2016 e cila, kjo kontrate qeraje, nuk provon qe ky operator ekonomik ka ne dispozicion te tij ambiente per gjate gjithe kohes se kontrates per te cilen ka paraqitur oferte. Ky ambient i eshte vene ne dispozicion operatorit ekonomik Shpresa shpk per te kryer sherbimin lavanteri ekskuzivisht te Spitalit Berat, e shprehur kjo tek leja mjedisore tipi C (pika 2); Dokumentacioni ne lidhje me ambientet i sjelle nga anetari tjetër i BOE “Servizi Sanitari Integrati” nuk mund te merren ne konsiderate ne kushtet kur vendendodhja e tij eshte ne Itali, dhe nuk ka paraqitur asnje dok tjetër i cili provon se ka ne*

dispozicion ambiente per realizimin e sherbimit ne Shqiperi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik duhet te disponoje ambjente ku ushtron veprimtarine e sherbimit te lavanterise. Te vertetoje me dokumentacionin perkates per ambjentin ku ushtron veprimtarine e sherbimit te lavanterise e cila eshte ne pronesi apo e marre me qera .

- *Te shoqeruar me leje autorizim mjedisor per aktivitetin ne lavanteri leshuar nga autoriteti perkates, ndersa per operatoret e huaj leje te barazvleshme nga vendi qe kryen aktivitetin.*
- *Te shoqeruar me akt –teknik per sa i takon masave mbrojtese ndaj zjarrit.”*

III.2.2. Nga verifikimi i ofertës së bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” srl rezulton se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

Shoqëria “Shpresa” sh.p.k:

1. Kontratë qiraje me nr. 1461 prot., datë 30.12.2016 lidhur ndërmjet Drejtorisë së Spitalit Rajonal Berat (qiradhënësi) dhe subjektit “Shpresa” sh.p.k (qiramarrësi). Objekti i kontratës është dhënia me qira e objektit “Lavanteri”, njësi në administrim të Spitalit Rajonal Berat, me sip.72 m2, sipas planimetrisë bashkëngjitur.
2. Leje mjedisore e tipit C për aktivitetin “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit në datën 24.11.2014, Subjektit “Shpresa” sh.p.k. Vendi i kryerjes së veprimtarisë është: “Q. Berat, Spitali Rajonal Berat.”
3. Akt-Miratimi “Leje mjedisi Tipi C” lëshuar nga Ministria e Mjedisit në datën 24.11.2014 për personin juridik “Shpresa” sh.p.k, me adresë “Spitali Rajonal Berat”
4. Certifikatë lëshuar nga Drejtoria MZSH Berat për objektin “Lavanteri Shpresa sh.p.k” me adresë Spitali Rajonal Berat.

Shoqëria “Servizi Sanitari Integrati” srl.

1. Kontratë qiraje e lidhur ndërmjet personit fizik me inicialet A.C (qiradhënësi) dhe “Servizi Sanitari Integrati” srl (qiramarrës), për përdorimin për lavanteri jo të hapur ndaj publikut të pasurisë së paluajtshme, me adresë: Castel Morrone (CE) në Rr. Ponte Vecchio 13.
2. Autorizim për shkarkimin e ujrave të zeza (neni 124 dhe 125 dhe Direktiva nr. 152/2006).
3. Certifikatë për parandalimin e zjarrit, lëshuar nga Ministria e Brendshme, Shtabi Provincial i Zjarrfikësve të Caserta, në emër të shoqërisë “Servizi Sanitari Integrati” srl, e vlefshme nga data 10.03.2010 deri në datën 11.03.2016.
4. Certifikatë për rinovimin peiodik të Aktit Teknik kundra zjarrit datë 12.02.2016, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi për kompaninë “Sarvizi Sanitari Integrati” srl, me vendndodhje në Ponte Vecchio, Komuna “Castel Morrone [...]”.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gëmra “b” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.[...]”

Ndërkohë, neni 53, pika 3, i LPP-së, përcakton që: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.2.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1 dhe 3 parashikohet se :

“1 Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

III.2.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Parashikimi i kriterit të sipërcituar ka si qëllim të sigurojë autoritetet kontraktor mbi aftësinë teknike të operatorit ekonomik fitues, në drejtim të përmbushjes së kontratës dhe detyrimeve të saj, sipas standardeve të përcaktuara.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Shpresa” sh.p.k ka paraqitur një kontratë qiraje të lidhur me Spitalin Rajonal Berat, shoqëruar me dokumentacionin përkatës me të njëjtën adresë. Nga ana e ankimuesit është pohuar në ankesën e tij se është e vërtetë që kontrata e qirasë është vënë në dispozicion të shoqërisë “Shpresa” sh.p.k për të kryer shërbimin e lavanterisë ekskluzivisht për Spitalin Berat, e shprehur kjo te leja mjedisore tipi C, por sipas tij, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar që ambienti të mos jetë në funksion të ndonjë kontrate publike apo private ose afërsia e tij me qytetin e Durrësit.

Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Nga ana tjetër, operatorët ekonomikë kanë detyrimin ligjor të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e kërkuara në dokumentat e tenderit e në rastin konkret të vërtetojnë se disponojnë ambientet e duhura për kryerjen e shërbimit të lavanterisë me qëllimin e vetëm për të bërë të mundur zbatimin e kontratës për furnizimin e shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Në kushtet kur shoqëria “Shpresa” sh.p.k ka vërtetuar se disponon ambient për kryerjen e shërbimit të lavanterisë ekskluzivisht për Spitalin Rajonal Berat, ky fakt nuk garanton autoritetin kontraktor se ky ambient do të shërbejë edhe për realizimin e shërbimit të kërkuar nga ky i fundit për Spitalin e Durrësit, pasi ekskluziviteti përjashton cdo ofrim shërbimi nga destinacion tjetër përtej atij të largjes së materialeve të Spitalit Berat.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit se autoriteti kontraktor nuk ka specifikuar në dokumentat e tenderit *që ambienti të mos jetë në funksion të ndonjë kontrate publike apo private*, sqarojnë se përderisa në dokumentat e tenderit është kërkuar që subjektet duhet të provojnë se disponojnë ambiente për kryerjen e shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës, disponimi i këtij ambienti ekskluzivisht për Spitalin Berat dhe në ambientet e këtij spitali, nuk siguron besueshmëri për realizimin me sukses të kontratës.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2.7. Përsa i përket shoqërisë “Servizi Sanitari Integrati” srl, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacion që provon se ambienti për kryerjen e shërbimit të lavanterisë është me vendndodhje në Itali. Referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se autoriteti kontraktor kërkon, përveç të tjerave, që operatori ekonomik të ofrojë shërbimin e tij për procesin e lavanterisë për sasinë 476,190 kg, për 30 muaj për Spitalin Durrës. Në kushtet kur operatori ekonomik “Servizi Sanitari Integrati” srl ka marrë përsipër 80,7% të kryerjes së shërbimit, sipas aktmarrësveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis tij dhe shoqërisë “Shpresa” sh.p.k, dhe objekti i prokurimit është në Durrës, Shqipëri, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e kësaj shoqërie nuk përmbushet kërkesa e autoritetit kontraktor për ambientin e lavanterisë, të nevojshëm për realizimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 46 të LPP-së sipas të cilit *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Shpresa” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” srl në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” srl nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P mbetet e skualifikuar, ndaj dhe shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k për operatorin ekonomik “Sanitary Cleaning” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.4.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k & “Servizi Sanitari Integrati” srl, mbetet i skualifikuar në bazë të arsyetimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimit të shoqërisë “Shpresa” sh.p.k në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tij të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

III.5. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në datën 24.07.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton se oferta e operatorit ekonomik ankimues është skualifikuar.

III.5.2. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues rezulton se në datën 31.07.2017 shoqëria “Devis” sh.p.k ka nisur me postë ankesë pranë autoritetit kontraktor, ankesë e cila ka mbërritur në adresën e autoritetit kontraktor në datën 17.08.2017. Në datën 10.08.2017 operatori ekonomik ankimues ka protokolluar dorazi me nr. 1625 prot, ankesën e tij në autoritetin kontraktor me të njëjtën përmbajtje si edhe ajo e pretenduar në datën 31.07.2017.

III.5.3. Në datën 22.08.2017, operatori ekonomik “Devis” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesat e paraqitura pranë autoritetit kontraktor.

III.5.4. KPP sjell në vëmendje se në nenin 63, pika 1,2,5,6,7 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se:

“1.Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga utoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht dhe autoritetit kontraktor.7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor” Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.”

III.5.5. Në lidhje me respektimin e anës formale të dorëzimit të ankesës si edhe ndjekjeve të shkallëve të ankimit nga ana e operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se pala ankimuese është vënë në dijeni fillimisht në datën 24.07.2017 mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për klasifikimin e ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar, ku oferta e operatorit ekonomik ankimues rezulton e skualifikuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si edhe parashkrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si edhe aktit mbi trajtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se ankesa e parë e operatorit ekonomik ankimues “Devis” shpk është dorëzuar në autoritetin kontraktor në datë 10.08.2017, ndërsa ankesa e pretenduar se është nisur me postë në datën 31.07.2017 ka mbërritur në adresën e AK në datën 17.08.2017.

Në nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikë së Shqipërisë” parashikohet se: “Procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton se ankimuesi në asnjë rast nuk ka vënë në dispozicion dokument provues, mandat dërgimi postar apo cdo akt tjetër i cili vërteton se ankesa është marrë në dorëzim në çdo formë të parashikuar nga ligji nga ana e autoritetit kontraktor në datën e pretenduar (31.07.2017). Në rastin konkret, K.P.P gjykon se ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuarit). Sa më sipër, KPP gjykon se ankimuesi nuk ka provuar pretendimet e tij mbi datën e marrjes së ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

Në rastin e ankesave kundër vendimeve të autoritetit kontraktor (referuar nenit 63 pika 2 të LPP-së) në të cilën parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktori paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji” afati procedural për paraqitjen e ankesës pranë këtij të fundit si shkallë e parë e ankimit nis nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni.

Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar” *strictu sensu* parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrative pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

III.5.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik “Devis” shpk pranë autoritetit kontraktor dhe K.P.P nuk ka respektuar afatet e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, çka rrjedhimisht sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të

drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.5.7. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Shpresa” shpk për procedurën e prokurimit me prokurimit me Nr. Ref-10028-05-02-2017 me objekt: “Furnizimi i shërbimit të lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 166.666.500 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1374 Prot;
Datë 11.08.2017

Nr. 1406 Prot;
Datë 22.08.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha